REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 827/20
Datë/Datum. 19.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **632-20-4174-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – LOT 3**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K."
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Sadik Stavileci"
(Adresa)

GJAKOVË *(Vendi)*

50000 *(Kodi postar)*

+383 45 230 702 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

ALBERT BALA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

marashshped.ks@gmail.com
(Adresa elektronike)

19.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. MSH Marash-Shped GJAKOVË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – LOT 3.**

Njoftimi për kontrate është bërë me datën 10.08.2020 ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 01.09.2020.

Njoftimi për vendimin e AK-së për LOT 3 është bërë publik më datë 25.09.2020 ku fitues ishte shpallur OE "REA SHPK".

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, ne kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së me datë 30.09.2020.

Me datë 08.10.2020 AK ka publikua vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, andaj të pakënaqur me këtë vendim i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri për vlerësim ka qenë **Tenderi i Përgjegjshëm me Çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet,*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja publike është bërë me datë 01.09.2020. Nga procesverbali i hapjes publike shihet se në të nuk është evidentuar ndonjë vërejtje rreth mbarëvajtjes së këtij procesi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, ne kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së me datë 30.09.2020. Me datë 08.10.2020 AK ka publikuar vendimin për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë, i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit te kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP-së:

1. **AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së,**
2. **AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,**
3. **AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së,**
4. **AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,**
5. **AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe Rregulloren B57,**
6. **AK ka shkelur nenin 68 të LPP-së,**
7. **AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,**

AK ka shkelur edhe dispozita tjera RRUOPP-së gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve si dhe ka shkelur edhe praktikat e mira të prokurimit.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Gjate vlerësimit të tenderëve me rastin e rivlerësimit, AK ka bërë prapë shkelje të LPP-së ku pretendimet tona lidhur me këto shkelje janë si në vijim:

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin **6 të LPP-së** lidhur me Ekonomicitetin dhe Efikasitetin sepse ky nen decidivisht e thotë që: **të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit**, ndërsa tek rasti jonë AK-Komuna e Gjakovës nuk ka vepruar sipas këtij neni, por përkundrazi tenton ta dëmtoj buxhetin e komunës duke e shpërblyer një OE të papërgjegjshëm. OE i shpallur fitues nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tij mungojnë dëshmi mbi posedimin e disa prej pajisjeve të kërkuara.

Vlerësimi i tenderëve duke mos vepruar sipas kërkesave të nenit 7, 59, 60, 69 dhe 71 të LPP-së e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 6 të LPP-së dhe drejt dëmtimit të buxhetit të komunës.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin **7 të LPP-së** i cili ndër të tjera kërkon nga AK që gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit: **ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të**

barabartë dhe jo- diskriminuese.
Gjatë vlerësimit të tenderëve AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me këtë nen pasi që edhe përkundër asaj që OE që e ka shpallur fitues nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, e ka shpallur fitues.

Po shihet qartë sjellja jo profesionale e AK-së duke na **diskriminuar** neve që i kemi plotësuar të gjitha dëshmitë e nevojshme sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe duke e **favorizuar** OE të shpallur fitues i cili nuk ka arritur të plotësoj të gjitha kërkesat e AK-së. Kjo është një tregues shumë i qartë që dëshmon se AK ka shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin **56 të LPP-së** i cili kërkon nga AK që gjatë vlerësimit të tenderëve:

1. **Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:**

1.1 së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;
1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

AK nuk ka respektuar nenin 56 të LPP-së gjatë vlerësimit të tenderit të OE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti kishte mangësi të theksuara në ofertën e tij sepse nuk kishte arritur ti plotësoj kriteret e kërkuara nga AK-ja.
Në bazë të kësaj shihet haptazi se AK ka shkelur plotësisht nenin 56.1 të LPP-së duke shpërblyer e kontratë një OE që është plotësisht i papërgjegjshëm.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin **59 të LPP-së** pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk e ka respektuar dhe shfrytëzuar fare paragrafin 4 (katër) të këtij neni.
Neni 59.4 thotë që:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përkundër kësaj që ja kërkon nenin 59.4 i LPP-së si dhe përkundër asaj që OE i shpallur fitues ka qenë i papërgjegjshëm, AK prapë se prapë e ka shpallur fitues. Arsyeja pse mendojmë se AK nuk ka vlerësuar sipas nenin 59.4 të LPP është pasi që gjatë vlerësimit të tenderit që e ka shpallur fitues nuk i ka respektuar kërkesat e dosës së tenderit. Shiko në vazhdim sqarimin për secilën shkelje:
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ishin kështu:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Lot-III.dhe -IV.Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 290.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (kopje**

OE i shpallur fitues nuk i ka dorëzuar këto dëshmi por është munduar të i mbuloj me disa raporte bankare të cilat nuk tregojnë fare se si është arritur qarkullimi i kërkuar. Aty mundet të ketë huazime, shitblerje tokash apo gjithçka tjetër me që nuk dihet përmbajtja e transaksioneve që do të dëshmonin qarkullimin financiar. Deklaratat e ATK janë dëshmitë që AK i ka kërkuar dhe bazuar në nenin 56.3 dhe 59.4 të LPP-së, janë dëshmitë e vetme që duhet merren për bazë gjatë vlerësimit të ofertave lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare. Këto dëshmi mungojnë në ofertën e fituesit andaj lirisht mund të themi se ky kriter nuk është plotësuar.

Kriteri tjetër që nuk është plotësuar është ky:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Lot-III,Lot-IV ,Lot-V,dhe Lot-VI.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier I diplomuar apo master i ndertimtarisë me 5 vjet provoj pune pas diplomimit b.) një inxhinier I diplomuar apo master i komunikacionit me 5 vjet provoj pune pas diplomimit. ç.)një gjeodet(gjeometër)**	**Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a , diploma, kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë.**

OE i shpallur fitues ka dorëzuar një listë të stafit profesional dhe të punëtorëve por në atë listë mungon Inxhinieri i Komunikacionit si dhe i mungon edhe Gjeodeti. Për këta persona OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara por nuk e ka futur fare në listën e stafit profesional ashtu siç e kishte kërkuar AK. Sipas LPP-së dhe rregullave mbi vlerësimin kjo është informatë e pa kompletuar por kur të e krahasojmë edhe me kërkesat e nenit 72 të LPP dhe 39 të RRUOPP-së, lista e stafit nuk mundet të sqarohet, atëherë kjo tregon se kërkesa e tillë nuk është plotësuar. Shiko dëshminë e paraqitur:

LISTA E STAFIT

	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Ngritja Profesionale
1	Agim Kastrati	Drejtor	Ing i Xehetaris
2	Muje Kelmendi	Udheheqes Teknik	Ing i Ndërtimtatisë
3	Nystret Kastrati	Menaxher i projektit	Ing i Ndërtimtatisë
4	Gentiana Millaku	Finanicer	
5	Labinot Kastrati	Manipulues	
6	Etnik Kastrati	Vozites	
7	Hamdi Gashi	Punetor	
8	Arbnor Gashi	Manipulues	
9	Fatjon Gashi	Punetor	
10	Ramiz Fazlia	Vozites	
11	Kreshnik Dugolli	Punetor	
12	Fidan Dreshaj	Manipulues	
13	Granit Kastrati	Vozites	
14	Brendon Racaj	Punetor	
15	Arbnor Racaj	Vozites	
16	Baton Gashi	Punetor	
17	Betim Gashi	Punetor	
18	Driton Sapunxhiu	Punetor	
19	Eldin Muharremi	Vozites	
20	Fisnik Zatriqi	Manipulues	

REA SH.p.k.

Pra edhe kërkesa e AK-së për listën e stafin profesional me kualifikime shkollore dhe profesionale nuk është plotësuar, që e forcon akoma mendimin tonë se ky OE është i papërgjegjshëm.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit të OE që e ka shpallur fitues nuk i ka trajtuar si duhet çmimet e ofruara si jo-normalisht të ulëta nga ky OE. Në paramasën e OE që AK e ka shpallur fitues vërehen çmime jo-normalisht të ulëta nëpër pozicione dhe atë për pozicionet si më poshtë:

POS	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit mbushes guror rrethanor. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m^3		2
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushes 50-150mm t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m^3		2
3	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm, t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>60 MPa Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m^3		3
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 0/16 mm në rrugë, t=8cm	m^2		8.00

Të gjitha këto çmime janë çmime jo normalisht të ulëta dhe AK është dashur ta sqaroj OE sipas nenit 61 të LPP-së dhe sipas rregullores B57 – Rregullat për Tenderët jo-normalisht të Ulët përkatësisht pikën 4 të kësaj rregulloreje. Mos trajtimi i këtyre çmimeve nga ana e AK-së e shtynë këtë të fundit drejt shkeljes së nenit 61 të LPP-së. Çmimet e tilla janë çmime shumë të ulëta në krahasim me çmimet e tregut si dhe janë çmime spekulative sa për ta ulur vlerën e çmimit të përgjithshëm të tenderit. Kjo është e ndaluar sipas LPP-së dhe me të drejt konsiderohet shkelje edhe për OE por edhe shkelje për AK-në.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 68 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit të tenderit që e ka shpallur fitues nuk i ka trajtuar si duhet dëshmitë e ofruara nga ai lidhur me Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare. Nenin 68 të LPP-së, AK e ka shkelur me rastin e vlerësimit të OE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti nuk i plotëson kërkesat nga dosja e tenderit siç ishin kërkuar lidhur me dorëzimin e **Deklaratave Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**
Kjo konsiderohet mos respektim i kritereve të vendosura nga vet AK paraprakisht në dosjen e tenderit dhe njëkohësisht del të jetë shkelje e plot e nenit 68 të LPP-së.

Pretendimi 7: AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit të OE që e ka shpallur fitues nuk i ka trajtuar si duhet dëshmitë e ofruara lidhur me Kërkesat mbi gjendjen

ekonomike dhe financiare. Nenin 69 të LPP-së, AK e ka shkelur me rastin e vlerësimit të OE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti nuk e plotëson kërkesën që ishte kërkuar nga AK për dorëzimin e Listës së stafit profesional ku duhej të tregoheshin kualifikimet shkollore dhe profesionale. Kjo konsiderohet mos respektim i kritereve të vendosura nga vet AK paraprakisht në dosjen e tenderit dhe njëkohësisht del të jetë shkelje e plot e nenit 69 të LPP-së.

Përpos shkeljes së neneve që i cekëm më lartë, AK ka shkelur edhe dispozitat tjera RRUOPP-së gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve si dhe ka shkelur edhe praktikat e mira të prokurimit që lidhen me vlerësimin e drejt të OE dhe respektimin e kërkesave nga dosja e tenderit.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara, shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes Ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e **Grupit të OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K."** lidhur me tenderin **"Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – LOT 3".**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **AK – KOMUNA GJAKOVË** dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe në detyrimet që i ka AK-ja ndaj LPP-së dhe RRUOPP-së e që realisht më pas do të duhej që **Fitues** të shpallej **Grupit të OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K."**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë shumë të gjatë në fushën e punimeve të tilla.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Dosja e Tenderit-Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës
- 3 Proces verbali i hapjes-Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës
- 4 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-lot-1-2-3
- 5 KERKESA PER RISHQYRTIM NE AK - 30.09.2020
- 6 Vendimi per Refuzim te Kerkeses per Rishqyrtim 08.10.2020
- 7 Lista e stafit profesional dhe e punetoreve - REA SHPK
- PARAMASA-Zhdrellë-Bec-Lot-III (1)

Të gjitha dëshmitë tjera që lidhen me pretendimet tona i gjeni në dosjen e procesit të prokurimit të AK-së.